

Konkluzione nga monitorimi i kryer i masave në kuadër të Programit Qeveritar 2021 - 2024 për periudhën tetor 2020 - mars 2021

Gjashtëmbëdhjetë mobilizues të komunitetit në kuadër të projektit "Mbështetje e reformës zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut" në periudhën tetor 2020 - mars 2021 realizuan monitorim në lidhje me përmbushjen e premtimeve të partive politike të dhëna në periudhën parazgjedhore në suazat e programeve zgjedhore, përkatësisht më pas të shndërruara në Program të Qeverisë 2021 - 2024. Monitorimi u krye në gjashtë fusha: ekonomi, kulturë, drejtësi, çështje sociale, shëndetësi dhe arsim dhe mbuloi 16 grupe masash zbatimi i të cilave u monitorua në periudhën e lartpërmendur. Në vijim janë rezultatet nga monitorimi dhe konkluzione mbi progresin sipas fushave dhe në kuadër të masave të monitoruara. Monitorimi kryhet në përputhje me metodat e vendosura për mbledhjen e të dhënave si desktop analizë, intervista, anketa dhe kërkesa për informacione me karakter publik tek institucionet. Rezultatet dhe gjetjet paraqiten bazuar në materialin që mobilizuesit arritën të mbledhnin dhe i cili iu vu në dispozicion atyre. Prandaj, nuk përjashtojmë mundësinë të disa masa të ketë dallime midis gjetjeve të mobilizuesve dhe situatës aktuale faktike.

- Krahasimi i progresit sipas fushave


Në katër nga gjashtë fushat që janë subjekt i monitorimit, ka përparim ose progres të pjesshëm në realizimin e masave të parashikuara që monitorohen siç paraqitet në Grafikon 1. Progres shënojnë fushat e ekonomisë, drejtësisë, shëndetësisë dhe arsimit, me përparimin më të rëndësishëm në zbatimin e masave që janë lëndë e monitorimit në fushën e arsimit dhe shëndetësisë. Fusha e çështjeve sociale shënon progres shumë të vogël, ndërsa fusha e kulturës nuk ka bërë asnjë përparim pasi nuk janë filluar aktivitete në lidhje me masat lëndë e monitorimit. Duhet të theksohet se në këto dy fusha sfida ishte sigurimi i të dhënave të sakta dhe të azhurnuara në lidhje me masat e monitoruara.

Shkalla e progresit përcaktohet si më poshtë:

1 - 1,5 nuk ka progres dhe është shënuar me të kuqe

1,6 - 2,5 lëvizje ose progres i pjesshëm


2,6 - 3 progres i vazhdueshëm ose arritje



- Krahasimi i progresit sipas fushave, sipas tremujorëve

Krahasuar me tremujorët e monitorimit në tremujorin e parë, përparimi më i madh është regjistruar në fushat e ekonomisë, arsimit dhe shëndetësisë, ndërsa përparimi më i vogël është regjistruar në fushën e drejtësisë siç tregohet në Grafikon nr.2. Midis tremujorëve, përparim më i madh është bërë në fushat e drejtësisë dhe arsimit.

Grafiku nr. 2 - Krahasimi i progresit sipas fushave, për tremujor



- Krahasimi i përparimit sipas masave, sipas tremujorëve

Në vazhdim të Grafikut nr. 3 është paraqitur progresi i masave në suazat e gjashtë fushave. Gjatë kësaj, progres më i madh midis tremujorëve mund të konstatohet në masat në fushat e Drejtësisë dhe Arsimit, veçanërisht në pjesën e arsimit digjital. Disa masa në fushën sociale tregojnë një ulje të progresit, pjesërisht për shkak të mos pasjes qasje në informacionet mbi masat specifike, por edhe për shkak të zhvillimeve në kontekstin dhe ndikimin e pandemisë me Covid 19, që në një farë mase kufizoi zbatimin e plotë të masave.

Krahasimi i progresit sipas masave, për tremujor

